



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deoničarsko Društvo

Nr. 4675 Data 01.09.2023
Mitrovicë Mitrovica



Në mbështetje të nenit 3 paragrafit 1, nën-paragrafit 1.4 dhe nenit 9 paragrafit 8, nën-paragrafit 8.1 të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën, të nenit 6 paragrafi 2, nenit 19 paragrafit 2, nën-paragrafit 2.3 dhe nenit 21 të Statutit të Trepça Sh. A dhe nenit 4 paragrafi 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh. A me datën 01.09.2023, shpall:

KONKURS PUBLIK

Për anëtarë (udhëheqës të njësive biznesore) të Bordit Menaxhues të Trepça Sh. A

a). Pozita: Udhëheqës i njësisë biznesore Fabrika e pajimeve të Procesit

1. Të përgjithshme

Kandidatët për këtë vende pune duhet të jenë persona me integritet, të cilët plotësojnë kushtet e kualifikimit, duhet të kenë përvojë të nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar.

2. Mandati i Udhëheqësit të njësisë biznesore të Trepça Sh. A

Udhëheqësi i njësisë biznesore i Trepça Sh. A. zgjidhet përmes procedurave publike në përputhje me legjislacionin në fuqi nga Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh. A për mandatin prej 3 (tri) vjetëve, me mundësi të vazhdimit edhe për një mandat.

3. Kompensimi i Udhëheqësit të njësisë biznesore të Trepça Sh. A

Kompensimi dhe përfitimet e Udhëheqësit të njësisë biznesore të Trepça Sh. A do të përcaktohen sipas Rregullores për Sistematizim dhe Organizim të Ndërmarrjes Trepça Sh. A , në përputhje me deklaratën për politikën e kompensimit të ndërmarrjes.

4. Përshkrimi i punëve

- Në bashkëpunim të ngushtë me Bordin Mbikëqyrës dhe Kryeshefin Ekzekutiv udhëheqë zhvillimin strategjik të Njësisë biznesore;
- Propozon plane, projekte investuese për njësitë e Trepça Sh. A;
- Është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të njësisë duke siguruar qëndrueshmërinë afatgjate financiare të saj;
- Siguron vendosjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të informacionit duke i mundësuar njësisë të ekzekutoj aktivitetet e saj në mënyrë të ligjshme dhe etike;
- Organizon, mbikëqyrë dhe mbanë përgjegjësi për të gjitha çështjet e biznesit të njësisë;
- Raporton tek Bordi Mbikëqyrës dhe Kryeshefi Ekzekutiv i Trepça Sh. A;
- Për punën e tij i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv;

- Kryen dhe punë të tjera të përcaktuara me ligjet e zbatueshme, Statutin dhe aktet tjera të brendshme të ndërmarrjes.

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Një kandidat për t'u zgjedhur në pozitën e **Udhëheqësit të njësisë biznesore** të Trepça Sh. A, duhet plotësoj kushtet, të ketë kualifikime dhe përvojë pune, si vijon:

- Të posedojë diplomë universitare –inxhinier i diplomuar i makinerisë apo master, inxhinier i diplomuar i gjeologjisë apo master, inxhinier i diplomuar i metalurgjisë apo master, ekonomist i diplomuar apo master, jurist i diplomuar apo master, administrim të biznesit apo master si dhe çdo drejtim tjetër relevant me këto.
- Duhet të ketë së paku 5 vite përvojë pune.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

I. Kandidatët për pozitën e Udhëheqësit të njësisë biznesore të Trepça Sh.A duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formularin e aplikimit;
- CV-në;
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në vendin e dorëzimit të tyre);
- Diplomat e fituara jashtë shtetit duhet nostrifikuar;
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional si diplomën universitare dhe dëshmi tjera të ngjashme, dëshmi për përvojën e punës);
- Certifikatën nga gjykata se nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi duhet të plotësoj personalisht deklaratën nën betim, me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Aplikuesi duhet të plotësoj formularin e aplikimit i cili merret në zyrën e protokollit të Trepça Sh. A.

Dokumentacioni ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i njësisë biznesore në të cilën konkurren kandidati dhe të dorëzohen në arkivin e zyrave qendrore të Trepça Sh. A., në Parkun Industrial në Mitrovicë.

I gjithë dokumentacioni duhet të jetë në formë origjinale ose në kopje të noterizuar. Diplomat universitare të marra jashtë shtetit, duhet të sillen së bashku me vendimin për nostrifikim nga MASht.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në Web faqen zyrtarë të Trepça Sh. A.

Për informata shtesë:

Email adresa: contact@trepcasha.com